



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 23 mars 2020
Nr. ref.:RK 1533/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI130/19

Parashtrues

Fahri Mati

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 19/2019,
të 8 majit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Fahri Mati, pronar i kompanisë “Silver – Co – Termo Climo” nga Prizreni (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Miftar Qelaj, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 19/2019, të 8 majit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 31 [Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 gusht 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 21 gusht 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 28 gusht 2019, Gjykata njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 27 nëntor 2019, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga shkresat e lëndës rrjedh se parashtruesi i kërkesës, si pronar i kompanisë “Silver – Co –Termo Climo” me seli në Prizren, kishte lidhur një marrëveshje me gojë me kompaninë “Getoari”, e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, sipas së cilës kompania e tij do të kryente punë të caktuara në pjesën e cila shtrihet në Republikën e Shqipërisë. Sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, vlera e kontraktuar me gojë e punimeve që “Getoari” duhej t'i

paguante kompanisë së tij "Silver – Co –Termo Climo" ishte 53,872.03 €. Mirëpo, kompania "Getoari" i kishte paguar parashtruesit të kërkesës vetëm shumën prej 5,027.10 €.

10. Parashtruesi i kërkesës inicioi procedurë kontestimore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) kundër të paditurit, kompanisë "Getoari" zyrës në Prizren, për borxhin e mbetur që nuk i është paguar kompanisë "Silver – Co –Termo Climo" për punimet e kryera në segmentin e autostradës e cila shtrihet në Republikën e Shqipërisë. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Themelore – Departamenti për çështje ekonomike si vlerë të kontestit e ka çekur shumën prej 3000 €.
11. Kompania e paditur "Getoari" zyra në Prizren e kontestoi padinë në tërësi, duke pretenduar se *"ajo nuk e ka legjitimitetin e të paditurës, andaj Gjykata [Themelore] nuk ka juridiksion për këtë çështje për faktin se raporti kontraktual është arritur në Shqipëri në mes të "Bechtel Enka" dhe ndërmarrjes "Getoari" me seli në Shqipëri, dhe punët sipas kësaj kontrate janë kryer në territorin e Shqipërisë, për të cilën Gjykatës [Themelore] i ka prezantuar certifikatën e biznesit dhe kopjen e kontratës së lartpërmendur".* E paditura gjithashtu deklaroi se vlera kontraktuale me gojë e punimeve që parashtruesi i kërkesës i kishte bërë në vend të kompanisë "Getoari" sh.p.k., me seli në Shqipëri, ishte paguar plotësisht në vendin ku ishte lidhur kontrata me gojë, përkatësisht në Republikën e Shqipërisë.
12. Më 25 tetor 2018, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin EK. nr. 299/2016, me të cilin shpallet gjykatë jokompetente për të vendosur në këtë çështje juridike, ndërsa hedh poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës kundër kompanisë "Getoari" zyra në Prizren, në këtë çështje juridike si të palejueshme.
13. Me të njëjtin aktvendim, Gjykata Themelore gjithashtu i shpalli të pavlefshme të gjitha veprimet e kryera nga kjo gjykatë në këtë çështje juridike.
14. Në arsyetimin e Aktvendimit EK. nr. 299/2016, Gjykata Themelore theksoi:

"Nisur nga kjo gjendje e çështjes, gjykata vlerëson se çështja e ngritur me padi nuk hyn në kompetencën të gjykatës se vendit (Republikës së Kosovës), për të vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditësit e çka nënkupton faktin se Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje ekonomike, nuk është kompetente për të vendosur në këtë çështje juridike.

Nga shikimi në shkresa të lëndës dhe deklarimeve të palëve, më saktë të paditurit i cili në vazhdimësi ka kontestuar legjitimitetin e tij në procedurë, duke theksuar se raporti kontraktual në bazë të së cilës paditësi ka kryer punë në autostradën Kukës, është krijuar në mes të "Getoarit", sh.p.k me seli në Shqipëri dhe paditëses, dhe jo "Getoarit" me seli në Prizren.

Kështu që nga gjendja e regjistrimit e lëshuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra Kombëtare e Biznesit, shihet se "Getoari", sh.p.k, me numër unik të identifikimit të subjektit K78410201A, me administrator Naim Besimi, e ka selinë në Shqipëri, Kukës rruga e tregut, pranë Ndërmarrjes së Shërbimit Publik. Gjithashtu "Getoari", sh.p.k., me seli në Kukës Shqipëri, në cilësinë e nënkontraktuesit me datë 21.10.2008, ka lidhur kontratë me "Bechtel Internacional, Inc dhe Enka Insaat ve Sanayi A.S.", për kryerjen e punëve në projektin e autostradës Shqiptare.

Për më tepër Gjykata e vlerësoi edhe pretendimin e paditësit se i njëjti ka lidhur kontratë me të paditurën "Getoari", me seli në Prizren, për kryerjen e punëve në autostradën Kukës në Shqipëri, mirëpo paditësi nuk i ka ofruar prova gjykatës që ta provoi këtë fakt.

Me dispozitën e nenit 18.1 të LPK-së, është përcaktuar se gjykata sipas detyrës zyrtare gjatë gjithë procedurës kujdeset nëse zgjidhja e kontestit hynë ose jo në kompetencën gjyqësore, ndërsa me dispozitën e nenit 18.3 është paraparë se kur gjykata gjatë zhvillimit të procedurës konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata e vendit do të shpallet jokompetente".

15. Sa i përket këshillës për mjetin juridik, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në aktvendim ka theksuar "*Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh Gjykatës së Apelit*".
16. Më 27 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që të anulohet aktvendimi i kontestuar.
17. Më 30 janar 2019, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin Ae. nr. 5/2019, me të cilin ankesën e parashtruesit të kërkesës së parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje ekonomike, EK. nr. 299/2016, të 25 tetorit 2018, e hodhi poshtë si të paafatshme.
18. Në arsyetimin e Aktvendimit Ae. nr. 5/2019, Gjykata e Apelit theksoi:

"... afati për ankesë sipas dispozitës së nenit 509, pika c), të LPK-së, është 7 ditë nga dita e pranimi të aktvendimit, rezulton që ankesa është dorëzuar pas skadimit të afatit ligjor prej 7 ditësh, për faktin se afati fillon të llogaritet nga data 15.11.2018 dhe kur llogariten 7 ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë data 21.11.2018. Meqë paditësi ankesën e ka paraqitur me datë 27.11.2018, atëherë rezulton se ankesa është paraqitur me vonesë prej 6 ditësh".

Pavarësisht se gjykata e shkallës së parë në këshillën juridike të aktvendimit të atakuar, e ka udhëzuar palën e pakënaqur lidhur me të drejtën e ankesës dhe gabimisht e ka shënuar afatin prej 15 ditësh për ushtrimin e ankesës, rrethanë kjo e cila sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë nuk mund të ndikoj në zgjatjen e afatit të ankesës ndaj një aktvendimi për të cilin neni 509, pika c), e LPK-së, përcakton afatin 7 ditë,

nga dita e pranimit të aktvendimit. Afati për ushtrimin e ankesës përbën afat ligjor i cili nuk mund të ndryshojnë me asnjë vendim të gjykatës ndërsa përfaqësuesi i paditësit është avokat dhe supozohet se e njeh ligjin respektivisht ka pasur detyrim që të veprojë konform dispozitave të LPK-së”.

19. Parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesë për revizion të Aktvendimit Ae. nr. 5/2019 të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni dhe të anulohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë.
20. Më 8 maj 2019, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin E. Rev. nr. 19/2019, me të cilin hodhi poshtë si të palejuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr. 5/2019, të 30 janarit 2019.
21. Në arsyetimin e Aktvendimit E. Rev. nr. 19/2019, Gjykata Supreme theksoi:

“Në rastin konkret kjo çështje kontestimore paraqet një kontest ekonomik-tregtarë pasi është në pyetje mosmarrëveshja në mes të dy subjekteve ekonomike që është vendosur nga Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Vlera e objektit të kontestit siç është përcaktuar më pas është 3.100 €, me dispozitën e nenit 508 të LPK-së parashihet se revizioni në kontestet tregtare ekonomike nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë, nuk i kalon 10.000,00 €, prandaj në kuptim të dispozitës së lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se revizioni është i palejuar pasi që vlera e objektit të kontestit nuk e kalon 10.000,00 €.

Pasi që gjykata e shkallës së parë nuk e ka hedhur revizionin e paditëses si të palejuar siç parashihet me nenin 218 të LPK-së, atëherë Gjykata Supreme të njëjtin e hedhë si të palejuar e në bazë të nenit 221 të LPK-së, pasi që në pyetje është kontesti në mes të subjekteve ekonomike me kërkesë në të holla që nuk e kalon shumën prej 10.000,00 € të përcaktuar me dispozitën e nenit 508 të LPK-së”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet gjyqësore kundër të cilave ai ka parashtruar kërkesë për mbrojtjen e kushtetutshmërisë kanë mangësi, të cilat qartë tregojnë për shkelje të parimeve të nenit 31 [Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, si dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.
23. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, këto garanci kushtetuese u injoruan nga gjykatat e rregullta në të tri instancat, për faktin se “Gjykata e shkallës së I-rë në këshillën juridike të aktvendimit të atakuar, e ka udhëzuar

palën e pakënaqur lidhur me të drejtën e ankesës dhe gabimisht e ka shënuar afatin prej 15 ditësh për ushtrimin e ankesës në Gjykatën e Apelit”.

24. Një qëndrim i tillë juridik i Gjykatës Themelore shkel dispozitën kushtetuese të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], dhe rrjedhimisht shkel edhe dispozitat kushtetuese të nenit 31 dhe nenit 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), në lidhje me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.
25. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se pikërisht ai ka vepruar në bazë të këshillës për mjetin juridik të theksuar nga Gjykata Themelore në aktvendimin e saj, prandaj të gjitha të drejtat që gëzon pala në procedurën gjyqësore, dhe të cilat janë injoruar nga gjykatat e rregullta, përbëjnë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, dhe rrjedhimisht, i gjithë procesi gjyqësor në të gjitha fazat ishte i përfshirë me shkelje të së drejtës së tij për mjet juridik.
26. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë, për të konstatuar se ka pasur shkelje të së drejtës së garantuar me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, që ta shpallë të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AE. nr. 5/2019, të 30 janarit 2019 dhe ta kthejë procedurën në Gjykatën Supreme për rivendosje sipas ankesës.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

29. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë siç përcaktohen me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

30. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vlerëson se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën në cilësi të palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 19/2019, të 8 majit 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

31. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh edhe rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

32. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron se këshilla për mjetin juridik që ai mori nga Gjykata Themelore në Aktvendimin EK. nr. 299/2016, ka shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 32 të Kushtetutës, që çoi drejtpërdrejt në situatën që ai të mos ketë një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç parashihet me nenin 31 të Kushtetutës.

33. Më konkretisht, pas këshillës për mjetin juridik të Gjykatës Themelore të cekur në Aktvendimin EK. nr. 299/2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, por Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën me aktvendim si të paafatshme, sepse në pajtim me nenin 509, pika c) e LPK-së, afati i paraqitjes së ankesës është 7 (shtatë) ditë, e jo 15 (pesëmbëdhjetë) ditë siç përcaktohet në Aktvendimin e Gjykatës Themelore.

34. Me këtë, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës “i gjithë procesi gjyqësor në të gjitha fazat ishte i përfshirë me shkelje të së drejtës së tij për mjet juridik, me çka atij i është pamundësuar të ketë gjykim të drejtë dhe të paanshëm”.
35. Duke shqyrtuar kërkesën e parashtruesit, pretendimet e tij dhe vendimet e gjykatave të rregullta, Gjykata vëren se e tërë procedura gjyqësore e filluar nga parashtruesi i kërkesës në kërkesëpadi në Gjykatën Themelore karakterizohet nga një specifikë e caktuar. Kjo specifikë reflektohet në faktin se të gjitha procedurat gjyqësore pranë gjykatave të rregullta ndryshojnë si nga pikëpamja procedurale ashtu edhe materiale nga njëra-tjetra, për më tepër, çështjet të cilat kanë trajtuar gjykatat e rregullta janë të ndryshme në vetvete, dhe në pajtim me këtë edhe baza ligjore mbi të cilën gjykatat e kanë hedhur kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës janë të ndryshme.
36. Prandaj, Gjykata e sheh të domosdoshme që të analizojë në mënyrë të veçantë tërë procedurën gjyqësore që përfundoi me aktvendimin e kontestuar, dhe të përcaktojë nëse, siç pretendon parashtruesi i kërkesës, fakti që Gjykata Themelore në aktvendimin e saj kishte theksuar mjetin e gabueshëm juridik, çoi në shkelje të së drejtës për mjet juridik dhe rrjedhimisht në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, që është gjithashtu në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), e cila thotë se “është detyrë e Gjykatës të shqyrtojë procedurat në tërësi, duke përfshirë në rastin konkret vendimet e Gjykatave të Apelit (shih, ndër të tjera, Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Helmers kundër Suedisë*, i 29 tetorit 1991, Seria A. nr. 212, f. 15, paragrafi 31).
37. Në lidhje me këtë, duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, në pjesën përkatëse thekson:
- “Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.*
38. Gjykata gjithashtu rikujton nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, i cili në pjesën përkatëse thekson:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 32 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 dhe 6 të KEDNJ-së në Gjykatën Themelore

39. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës filloi procedurën kontestimore në Gjykatën Themelore në lidhje me detyrimet e papaguara që rrodhën nga një

marrëveshje me gojë që ai kishte lidhur me kompaninë “Getoari”, e regjistruar në qytetin e Kukësit, në Republikën e Shqipërisë. Sipas marrëveshjes gojore, parashtruesi i kërkesës do të duhej të kryente punimet ndërtimore në segmentin e autostradës e cila shtrihet në Republikën e Shqipërisë.

40. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës ka paditur kompaninë “Getoari” zyra në qytetin e Prizrenit, në Republikën e Kosovës, si palë në procedurën pranë Gjykatës Themelore.
41. Gjykata më tej vëren se për të vërtetuar bazueshmërinë e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore ndërmori disa veprime juridike për të vërtetuar gjendjen faktike dhe rrethanat të cilat mund të çojnë në përcaktimin e juridiksionit që ajo si gjykatë kompetente mund të merret me procedurën në fjalë.
42. Prandaj, me rastin e përcaktimit të gjendjes faktike, Gjykata Themelore konkludoi se, në bazë të nenit 18.3 të LPK-së ajo nuk ka juridiksion në çështjen në fjalë, duke marrë parasysh që parashtruesi i kërkesës ka lidhur marrëveshje me gojë me një kompani të regjistruar në territorin e një shteti tjetër dhe jo me kompaninë që ai deklaroi në kërkesëpadi, gjithashtu, që punimet ndërtimore janë kryer në territorin e një shteti tjetër, që çoi në përfundimin se, në pajtim me juridiksionin e saj territorial, ajo nuk ishte gjykatë kompetente të merrej me procedurën në fjalë.
43. Në lidhje me këtë, Gjykata, duke marrë parasysh faktet e rastit konkret dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore, konstaton se Gjykata Themelore zbatoi drejtpërdrejt dispozitën e nenit 18.3 të LPK-së, me të cilën parashihet *“që kur një gjykatë, gjatë procedurës, konstaton se gjykata nuk është kompetente për zgjidhjen e kontestit por ndonjë organ tjetër, atëherë ajo do të shpallet jokompetente, do të anulojë të gjitha veprimet e kryera procedurale dhe do ta hedhë poshtë padinë e paraqitur te ajo”*.
44. Megjithatë, Gjykata vëren se gjykata e rregullt nuk do të veprojë në atë mënyrë nëse juridiksioni i gjykatës vendore varet nga pëlqimi i të paditurit, në këtë rast, kompania “Getoari” në Prizren. Në përgjigje ndaj padisë së parashtruesit të kërkesës, kompania “Getoari” në Prizren nuk e ka pranuar legjitimitetin pasiv si palë e paditur. Prandaj, Gjykata Themelore konstatoi se çështja e ngritur në padi nuk ishte në juridiksionin e gjykatës lokale, prandaj, Gjykata Themelore u shpall gjykatë jokompetente dhe padia e parashtruesit të kërkesës u hodh poshtë.
45. Gjykata rikujton se me ligjin e aplikueshëm të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 37.1 dhe 38 të LPK-së, parashihet juridiksioni i përgjithshëm territorial i gjykatës ku ndodhet vendbanimi ose vendqëndrimi i të paditurit kur ai është person fizik/juridik. Me nenin 39.2 të LPK-së parashihet që për gjykimin në kontestet kundër personave juridikë të tjerë e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e të cilës ndodhet selia e tyre e regjistruar.

46. Gjykata rikujton gjithashtu se me dispozitën e nenit 54.1 të Ligjit për zgjidhjen e konflikteve të ligjit me dispozitat e shteteve të tjera përcakton që në kontestet pasurore-juridike, ekziston juridiksioni i një gjykate lokale nëse prona e të paditurit ose objektet e kërkuara me padi janë në territorin e Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh dispozitat e mësipërme, si dhe faktin se parashtuesi i kërkesës a) ka lidhur një marrëveshje me gojë për ekzekutimin e punimeve ndërtimore në territorin e një shteti tjetër, b) me një ndërmarrje të regjistruar edhe në territorin e një shteti tjetër, c) me ç'rast punimet ndërtimore të kontraktuara u kryen në territorin e një shteti tjetër, rrjedh se fjala është për një kontest juridiko-pronësor me një person juridik të një shteti tjetër, në të cilin gjykata vendase ose Gjykata Themelore nuk është kompetente të vendosë.
47. Prandaj, Gjykata konkludon se, në dritën e të gjitha gjetjeve dhe fakteve, Gjykata Themelore-Departamenti për çështje ekonomike, në mënyrë të drejtë, zbatoi dispozitat e nenit 18.3 dhe nenit 39.2 të LPK-së, në lidhje me juridiksionin që të mos merret me procedurën konkrete, me çka nuk vihen në dyshim shkeljet e garancive të parashtuesit të kërkesës të parapara me nenet 32 dhe 31 të Kushtetutës.

Pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkelje të nenit 32 në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës, si dhe nenin 13 në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në procedurat në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme

48. Duke marrë parasysh pretendimet e parashtuesit të kërkesës që ai i vë në lidhje me shkeljen e nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, në procedurat në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, Gjykata konsideron se çështja kryesore në të cilën ajo duhet të përgjigjet në lidhje me pretendimet e parashtuesit të kërkesës, është pyetja, “nëse këshilla juridike e Gjykatës Themelore ka ndikuar apo që mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave themelore të parashtuesit të kërkesës në procedurat që ai ndoqi në lidhje me kërkesëpadinë, dhe për çka Gjykata Themelore ishte shpallur jokompetente për shkak se ajo nuk ka kompetencë territoriale që të merret me të”.
49. Duke iu rikthyer kësaj çështjeje, Gjykata së pari do të vlerësojë nëse këshilla për mjetin juridik në vendimin e Gjykatës Themelore në ndonjë mënyrë e ka penguar parashtuesin e kërkesës që të shqyrtohet pretendimi i tij ankimor nga gjykata e instancës më të lartë, në rastin konkret të Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, ku ai do të mund të kishte ushtruar të drejtat e tij nga kërkesëpadia, ose këshilla për mjetin juridik e Gjykatës Themelore kishte mohuar drejtpërdrejt të drejtën e parashtuesit për një mjet efektiv juridik, dhe me këtë drejtpërdrejt ka ardhur deri te shkelja e nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, si dhe shkelja e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
50. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se, në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, neni 13 i KEDNJ-së kërkon ekzistencën e një mjeti juridik të brendshëm, i cili u mundëson autoriteteve kompetente të shqyrtojnë “ankesa të provueshme”

brenda kuptimit të Konventës dhe të sigurojnë mbrojtje përkatëse, me ç'rast vëllimi i detyrimeve të shtetit kontraktues në këtë aspekt varet nga natyra e ankesës (Shih aktgjykimin e GJEDNJ-së, *De Souza Ribeiro kundër Francës*, kërkesa nr. 22689/07, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2012, paragrafi 78).

51. Gjithashtu, GJEDNJ në aktgjykimin *Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar* konstatoi që “mjeti juridik sipas nenit 13 të KEDNJ-së duhet të jetë i tillë që të mundësojë autoritetit kompetent të vendosë për meritat e ankesës përkatëse për shkelje të Konventës (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 22414/93, e 15 nëntorit 1996, paragrafi 145).
52. Në fund, Gjykata rikujton se mjeti juridik sipas nenit 13 të KEDNJ-së duhet të jetë “efektiv” si në teori ashtu edhe në praktikë, dhe përdorimi i tij nuk mund të ndalohet në mënyrë të padrejtë nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve shtetërore. Megjithatë, efektiviteti i tij nuk varet nga siguria e një rezultati të favorshëm për paditësin (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Kudla kundër Polonisë*, kërkesa nr. 30210/96 e 26 tetorit 2000, paragrafi 157).
53. Duke marrë parasysh rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata konstaton se është një fakt i padiskutueshëm që Gjykata Themelore në vendimin e saj EK. nr. 299/2016, deklaroi se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të parashtrojë ankesë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit që e shpall atë jokompetente për të vendosur për rastin në fjalë. Në bazë të kësaj rrjedh se Gjykata Themelore nuk e trajtoi çështjen në merita sepse nuk kishte një “padi të provueshme” përkatësisht e paditura nuk kishte legjitimitet juridik.
54. Gjykata konstaton në të vërtetë se Gjykata Themelore vendosi të mos merrej me thelbin e kërkesëpadisë në bazë të konstatimit se parashtruesi i kërkesës kurrë nuk kishte hyrë në marrëdhënie juridike me palën e paditur, të regjistruar në territorin e Republikës së Kosovës, por me një kompani tjetër me të njëjtin emër e cila është e regjistruar në një vend tjetër dhe, në pajtim me këtë, Gjykata Themelore në pajtim me juridiksionin e saj, nuk ka mundur t'i ofrojë parashtruesit të kërkesës “mbrojtje përkatëse”.
55. Nga sa më sipër, rrjedh se këshilla për mjetin juridik e Gjykatës Themelore kishte të bënte me çështjen e juridiksionit të gjykatës dhe jo me meritat e kërkesëpadisë, nga e cila rrjedh se këshilla për mjetin juridik e Gjykatës Themelore nuk mund të ketë ndikuar drejtpërdrejt, zvogëluar ose mohuar të drejtat e parashtruesit nga kërkesëpadia që ai do të mund t'i realizonte nëse ankesa ishte parashtruar në Gjykatën e Apelit brenda afatit ligjor.
56. Më konkretisht, edhe nëse parashtruesi i kërkesës do të kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit brenda afatit ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore, sipas pretendimeve të Gjykatës së Apelit, ajo sigurisht që do të ishte hedhur poshtë, pasi ishte padi e palejueshme, “dhe si të tillë Gjykata

Themelore do të duhej ta kishte hedhur poshtë në pajtim me nenin 186.1 të LPK-së”:

“Neni 186.1 Ankesën e paraqitur tej afatit të parashikuar me ligj, atë jo të plotë, apo të palejueshme e hedhë poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore”.

57. Nga të lartcekurat, rezulton se Gjkata e Apelit, edhe në rast se ankesa do të ishte paraqitur brenda afatit, do ta kishte hedhur poshtë kërkesëpadinë e parashtruesit për shkaqe procedurale, dhe kështu ankesa e parashtruar në Gjykatën e Apelit nuk do të mund të kishte paraqitur një mjet adekuat juridik *“që do t'i mundësonte autoritetit kompetent të vendosë për meritat e padisë përkatëse”*, që është në pajtim me parimet dhe praktikën e GJEDNJ-së (shih aktgjykimin e cituar më lart të GJEDNJ-së *Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

58. Më tej, Gjkata vëren se Gjkata Supreme në aktvendimin e saj adresoi gjithashtu çështjen procedurale dhe jo thelbin dhe meritat e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, duke konkluduar se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës duhet të ishte refuzuar në pajtim me nenin 508 të LPK-së, i cili thotë:

“Neni 508. Revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10.000 €”.

59. Gjkata vëren se me këtë lëshim procedural të parashtruesit të kërkesës në rastin konkret, Gjkata Supreme e shfrytëzoi si bazë juridike në bazë të së cilës e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për revizion si të palejueshme, duke mos u lëshuar në meritumin e kërkesëpadisë. Gjkata Supreme në aktvendim konkludoi se *“[...] me dispozitën e nenit 508 të LPK-së parashihet se revizioni në kontestet tregtare ekonomike nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë, nuk i kalon 10.000,00 €, prandaj në kuptim të dispozitës së lartcitur, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se revizioni është i palejuar pasi që vlera e objektit të kontestit nuk e kalon 10.000,00 €”.*

60. Nga kjo rrjedh se mospërmbushja e këtij obligimi procedural, e ka sjellur parashtruesin e kërkesës në situatë që kërkesa e tij për revizion të mos shqyrtohet nga ana e Gjykatës Supreme, ngase vlera e cekur e kontestit prej 3100 €, të cilën parashtruesi i kërkesës e ka cekur në momentin e kërkesëpadisë në Gjykatën Themelore, nuk i përshtatet llojit të procedurës për të cilin, sipas ligjit mund të ushtrohet revizioni si mjet juridik në Gjykatën Supreme.

61. Nga kjo rrjedh se, edhe duke supozuar se ankesa është paraqitur brenda afatit në Gjykatën e Apelit, Gjkata Supreme, sipas konkluzionit në aktvendimin e saj, përsëri do ta kishte hedhur poshtë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës në procedurën e revizionit për arsye procedurale, pa hyrë në meritat e kërkesëpadisë.

62. Në bazë të kësaj, Gjykata konkludon se lëshimi i Gjykatës Themelore në lidhje me afatin kohor brenda të cilit parashtruesi i kërkesës mund të parashtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit bëhet e parëndësishme dhe ankesa si e tillë nuk do të shqyrtohej nga Gjykata Supreme, dhe rrjedhimisht ankesa si mjet juridik në rastin konkret nuk mund të ishte “efektive” as në teori dhe as në praktikë.
63. Gjykata më tej konkludon se ankesa e paraparë me ligj sigurisht paraqet një mjet efektiv juridik, por “efikasiteti dhe efektiviteti” i tij mund të varet nga vetë thelbi i çështjes në të cilën ai përdoret. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata është e mendimit se ankesa në rastin konkret ishte, që nga fillimi i procedurës, mjet juridik me të cilin parashtruesi i kërkesës nuk do të mund të ushtronte të drejtat e tij në të cilat ai është thirrur në kërkesëpadi, edhe nëse do të ishte dorëzuar brenda afatit, pikërisht për shkak të specifikës së rastit konkret, përkatësisht juridiksionit territorial të gjykatave të rregullta.
64. Gjykata duke marrë parasysh praktikën e vet gjyqësore, parimet dhe principet e GJEDNJ-së, dhe pas një analize gjithëpërfshirëse të garancive procedurale të neneve 32 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenet 13 dhe 6 të KEDNJ-së, konkludon se këshilla për mjetin juridik e Gjykatës Themelore, me të cilën parashtruesit të kërkesës i jepet mundësia që të parashtrojë ankesë brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Gjykatën e Apelit, nuk paraqet shkelje të të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 32 në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 13 në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së
65. Gjykata, në bazë të të gjitha të lartcekurave, thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës t’i mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë ndonjë provë *prima facie* që tregon për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, të 5 dhjetorit 2013).
66. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 27 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi